

VENDIM
Nr.578, datë 23.8.2006

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË KRUJË, TË QARKUT TË DURRËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore (lidhja 1), që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Krujë, të qarkut të Durrësit, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Krujë, të qarkut të Durrësit, miratuar me vendimin nr.13, datë 7.1.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë e Krujës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Krujës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Krujë

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1;11;12;16;20	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
32-48	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
49-51	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve sociale	Në pronësi
55-59	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
68;73;81	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit tokë jobujqësore	Në pronësi
65;66;67;69;70;71;72;79;80;82;83;84	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit tokë bujqësore	Në përdorim
85-262;433;434;435;436	Pyje, kullota	Në pronësi
264-318	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
319-323;337	Prona që përdoren në fushën e kulturës dhe sportit	Në pronësi
346-351	Varrezat publike	Në pronësi
420-426;428;429	Infrastrukturë (troje dhe sheshe)	Në pronësi
74;75;76;77;78;419	Zhvillim ekonomik	Në pronësi
427;430;431	Infrastrukturë (troje)	Në përdorim